REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 05 / 10 / 2026
Nr.Orgv Org.jed. 01 | Nr.Prot. Br.Prot. 116 | Nr.Faqeve. Br.Strana. 2
Ferizaj - Uroševac

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.116
Data: 30.09.2026

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), nenit 13 pika1.2 lidhur me nenin 15 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina (Gazeta Zyrtare (Nr.17/2012) dhe nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 30.09.2026 miraton këtë;

RREGULLORE
Për
Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr.01/Nr.109, të datës 31.08.2022.

Neni I

Me anë të kësaj rregullore plotësohet-ndryshohet rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr.01/Nr.109, të datës 31.08.2022, këto ndryshime janë ta paraqitura në tabelen si në vijim:

Kategoritë e klientëve	Propozimi për çmim të ri (pa TVSH)	Propozimi për çmim (me TVSH)
Amvisëritë (Të rregullta)	8.39 €	9.90 €
Amvisëritë (Mërgata – Faturë PAUSHALLE)	4.63 €	5 €
Tarifë Fikse	1 €	1.18 €
Bizneset me tarifa - kat. 1	13.80 €	14.90 €
Bizneset me tarifa - kat. 2	21.20 €	22.9 €
Bizneset me tarifa - kat. 3	36.02 €	38.9 €
Bizneset me kontratë 1.1 m³	23.98 €	25.9 €

Bizneset me kontratë 5.0 m³	101.76 €	109.9 €
Institucionet me kontratë 1.1 m³	23.98 €	25.9 €
Institucionet me kontratë 5.0 m³	101.76 €	109.9 €
Bizneset me tarifa - kat. 4	111.05 €	119.9 €
Kategori e veçantë - kat. 5	/ / / / / / / /	Vlera e Tarifës - E papërcaktuar Tarifa caktohet nga Kompania e Licencuar për Grumbullimin dhe Bartjen e Mbeturinave

A r s y e t i m

Ky ndryshim i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Ferizajt, Nr. 01/Nr.109, të datës 31.08.2022, bëhet me qëllim të përshtatjes dhe përmirësimit të dispozitave të rregullores, në funksion të menaxhimit më efikas të mbeturinave në territorin e Komunës së Ferizajt. Gjithashtu, me këtë ndryshim dhe plotësim rregullohet edhe **Neni 5, pika 5**, lidhur me mënyrën dhe kushtet e vendosjes së kontejnerëve për mbeturina, me qëllim të sigurimit të një organizimi më të përshtatshëm dhe funksional të shërbimit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave..

Neni II

Kjo rregullore hyn në fuqi (tridhjetë) 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

01.Nr.116
Data: 30.09.2026

Kryesuesi I KK-së

Xhavit Zariqi